

L I G J
Nr. 8948, datë 3.10.2002

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8087, DATË 13.3.1996 “PËR
SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË USHTARAKËVE TË MINISTRISË
SË RENDIT PUBLIK DHE TË SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR”, NDRYSHUAR
ME LIGJIN NR. 8521, DATË 30.7.1999**

Në mbështetje të nenit 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 8087 datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 19/1 të këtij ligji, pas shprehjes “... nxjerrë në lirim...” hiqet shprehja “...për braktisje detyre, si dhe ata që...” dhe në vend të saj vendoset shprehja “...për shkak se...”.

Këtij neni i shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:

“Ushtarakët, që nuk kanë përfituar nga ky ligj për shkak të nenit 19/1 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar në ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999, të cilët nuk janë dënuar me burg me vendim gjyqësor të formës së prerë për krime ushtarake, përfitojnë të drejtën e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve, nga çasti i lindjes së të drejtës për përfitim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr. 3515, datë 23.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**